



Nr. i Protokollit 04/5-150/1

Data 10.02.2022

Komisioni për shqyrtimin e Ankesave në përbërje të Lulzim Dërmaku-kryesues, Kastrat Ajdini-anëtar formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv me Vendimin nr. 04/5-691/1 dt.18.05.2021 dhe Ardita Geocaj-anëtare në bazë të vendimit me nr.04/5-147/1 të datës 09.02.2022 ka pranuar Ankesën 04/5-68/1 të datës 04.02.2022 të parashtruar nga Sadri Bahtijari nga Dragashi, kundër vendimit me nr 04/5-28/1 të datës 27.01.2022 për konkursin publik Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrja Publike Banesore dhe nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa nr. 04/5-68/1 të datës 04.02.2022 të parashtruar nga Sadri Bahtijari nga Dragashi, kundër vendimit me nr 04/5-28/1 të datës 27.01.2022 për konkursin publik Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrja Publike Banesore**
- II. **SHFUQIZOHET VENDIMI me nr. 04/5-28/1 të datës 27.01.2022, i Komisionit Përzgjedhës sipas konkursit publik të datës 03.12.2021 për pozitën Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrja Publike Banesore**
- III. **Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore:**
 1. Të Anuloj rezultatet e konkursit Publike dt.03.12.2021 dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë
 2. Të ftoj të gjithë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret për aplikim sipas komisionit vlerësues të cilë kanë aplikuar për pozitën Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrja Publike Banesore.

ARSYETIM

Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë më datë 27.01.2020 ka publikuar vendimin për përzgjedhjen në pozitën Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrjen Publike Banesore

Kundër këtij vendimi në komisionin për shqyrtimin e Ankesave ,ka parshtruar ankesë Sadri Bahtijari nga Drgashi me arsyetimin se i njeiti edhe përkundër faktit se është njoftuar se i plotëson kriteret e konkurimit i njeiti nuk është ftuar për testim së bashku me kandidatët e tjerë.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, pasi shqyrtoj shkresat e lëndës, ka gjetur se pretendimet e ankuesit Sadri Bahtijari nga Dragashi kundër vendimit nr 04/5-28/1 të datës 27.01.2022 për shkak të mos njoftimit për pjesëmarrje në testim me shkrim ashtu siq e parasheh neni 8 i UA 07/2017 qëndrojnë dhe për këtë arsye ka vendosur që të ftoj të gjithë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret për aplikim sipas komisionit vlerësues të cilë kanë aplikuar për pozitën Zyrtar/e për menaxhim të kërkesave dhe ankesave në Ndërmarrja Publike Banesore.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave ka gjetur se ankuesi Sadri Bahtijari është njoftuar përmes postës elektronike ,por që emaili i tij është shënuar gabimisht dhe si rrjedhojë e kësaj i lartëpërmenduri nuk e ka pranuar njoftimin.

Nga të lartëpërmenduarat, Komisioni për shqyrtimin e ankesave, gjeti se ankesa është e bazuar, prandaj edhe vendosi si në Dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur kundër këtij vendimi mund të ushtroj ankesë në afat prej 8 ditësh nga pranimi i vendimit në Inspektoriatin e Punës.

I dorëzohet :

- Arkivit të Ndërmarrjes
- Palës
- Divizionit të B. Njerëzore
- Komisionit

Komisioni:

1. Lulzim Dërmaku - kryetar
2. Kastriot Ajdini - anëtar
3. Ardita Gecaj- anëtare

